


5.2 VESHJE DEKORATIVE

GRAFIATO 1, 2, 3



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes	54 cp/paletë	2.2 kg/m ² 3.1 kg/m ² 3.8 kg/m ²	1 mm Full 2 mm Strukturë 3 mm Strukturë



GRAFIATO

Veshje dekorative që shërben për trajtimin e fasadave dhe sipërfaqeve të brendshme.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

GRAFIATO klasifikohet sipas standardit EN 998 - 1.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- Rezistencë e lartë ndaj kushteve atmosferike.
- Punueshmeri e mirë.
- Formon një strukturë të qëndrueshme dhe jetëgjatë.

FUSHA E PËRDORIMIT

GRAFIATO është i përshtatshëm për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mira hidroizoluese ngjitëse dhe elastike. Përdoret dhe për krijimin e veshjeve dekorative mbi sipërfaqe të mbushura me llaç çimento ose llaç themelor termoizolues të cilët paraprakisht është rrafshuar me Tecnofix ose një nga produktet e linjës DW Conexion. Gjithashtu përdoret në sistemet e jashtme termoizoluese si veshje dekorative.

PROÇEDURA E APLIKIMIT

Përgatitja e suportit

Suporti ku do të aplikohet grafiato paraprakisht duhet të pastrohet nga pluhurat si edhe mbetjet e naftës, vajrave verniqeve, dylli dhe nga materialet kundër ngjitjes. Pastrimi i vajrave, verniqeve, dyllit apo materialeve kundër ngjitjes realizohet mekanikisht ose në mënyrë manuale. Përpara aplikimit të grafiato suportit duhet të nivelohet me astarin e thatë Tecnofix. Suportet duhet të jenë të sheshta dhe mekanikisht të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit.

MËNYRA E APLIKIMIT

GRAFIATO aplikohet me anën e një malle metalike të drejtë direkt mbi sipërfaqen e paratrajtuar me astarin TECNIFIX LIQUID. Mbas vendosje së produktit mbi suport bëhet fërkimi me anë të një malle plastike në mënyrë që të krijohen strukturat që duam.

PAKETIMI

GRAFIATO është i ambalazhuar në thasë 25 Kg.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazh origjinal të pahapur dhe i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diellit dhe nga ngricat.



KONSUMI

Varet nga dimensioni gurit

Dimensioni gurit (mm)	Konsumi (Kg/m ²)
1 mm	2.5 Kg/m ²
2 mm	3.0 Kg/m ²
3 mm	3.5 Kg/m ²

TË DHËNAT TEKNIKE

Forma	Pluhur me bazë çimento
Ngjyra	E Bardhë
Pesha volumetrike	1350 Kg/m ³
Sasia e ujit për përgatitje	25 - 27%
Pesha volumetrike e llaçit	1550 Kg/m ³
Temperaturat e aplikimit	+5°C deri në +35°C

